



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARIMIT
ZYRA PËRMBARIMORE LUSHNJE

Nr. 523 Regj

Lushnje, më 02.08.2021

VENDIM – SHPALLJE

(Lidhur me ekzekutimin e “Urdhërit të Ekzekutimit” të titullit ekzekutiv të debitorit)

Në Lushnje, sot më datë 02.08.2021,

Unë Endrin Kashari, me detyrë Përmbaues Gjyqësor pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje, pasi studiova aktet procedurale të çështjes përmbaimore nr.523, datë 27.07.2021 bazuar në urdhërin e ekzekutimit nr.298, datë 21.07.2021 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje,

K O N S T A T O V A :

Se në datë 27.07.2021 është depozituar pranë Zyrës së Përmbaimit Lushnje kërkesa e kreditorit Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje së bashku me “ Urdhërin e Ekzekutimit ” nr.298, datë 22.07.2021 të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për vendimin me nr.118, datë 09.06.2021 të Gjykatës së Shkallës së Shkallës së Parë Lushnje me palë:

- Kreditor : Buxheti i Shtetit
- Debitor : Shkëlqim Hasan Xhogu
- Objekti : Shpenzime procedurale

Nga ana e Zyrës së Përmbaimit Lushnje ka filluar procedurat në bazë të nenit 515 e vijues të K.Pr. Civile si dhe ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor*”, i ndryshuar për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv të sipërcituar.Nga verifikimi i kryer nga ana jonë në bashkëpunim me organet kompetente rezulton se debitori Shkëlqim Hasan Xhogu nuk ka marr dijeni nëpërmjet shërbimit postar, si rezultat i kësaj bazuar në nenet 133/a, 133/b dhe 144/a si dhe neni 517 të Kodit të Proçedurës Civile duhet të bëhet njoftimi me shpallje publike e debitorit lidhur me detyrimin që ka ai ndaj palës kreditore Buxhtetit të Shtetit për shpenzime procedurale në vlerën 1120 lekë.

Sa më sipër në mbështetje të nenit 133/a, 133/b, dhe 144/a si dhe 517 të Kodit të Proçedurës Civile dhe ligjit nr.8730, daë 18.01.2001 “ *Për Organizimin dhe Funksionimin e Shërbimit Përmbaimit Gjyqësor*”, i ndryshuar.

V E N D O S A :

1. Të kryej njoftimin nëpërmjet shpalljes publike me afat 20 (njëzet) ditor (duke marr parasysh edhe komunimin postar), nga data 02.08.2021 – 22.08.2021 të debitorit Shkëlqim Hasan Xhogu;
2. Ky vendim përpilohet në disa kopje, ku një kopje afishohet në vëndbanimin e fundit të palës debitore , një kopje afishohet në këndin e njoftimit të Zyrës së Përmbarimit Lushnje, një kopje dërgohet për afishim pranë në këndin e publikimeve të Bashkisë Lushnje, një kopje dërgohet për afishim në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe një kopje dërgohet për publikim në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.
3. Kjo shpallje publike ka vlerën e aktit të njoftimit për palën debitore Shkëlqim Hasan Xhogu me banim në lagjen “Xhevdet Nepravishta”, Bashkia Lushnje;
4. Pala debitore Shkëlqim Hasan Xhogu me banim në lagjen “Xhevdet Nepravishta”, Lushnje të paraqitet pranë Zyrës së Përmbarimit Lushnje në lagjen “ Çlirim” , kati i parë, hyrja mbarapa në ambjentet e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnje dhe të marr kontaktet me përmbaruesin gjyqësor të çështjes përmbarimore për t’iu vënë në dispozicion aktet e dosjes përmbarimore, pasi me kalimin e këtij afati do të vijohet me ekzekutim detyruar sipas nenit 519 e ne vijim të Kodit të Proçedurës Civile.

U shpall në Lushnje, sot më datë 02.08.2021.

KRYETAR I ZYRËS
Endrin Kashari
ME URDHËR DHE POROSI
PËRMBARUES GJYQËSOR
Brikena Luto

